

1 E martë, 16 prill 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Deklaratë përmyllëse]

4 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 09.30

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëmengjes. Mirë se erdhët.

8 Znj. Sekretare e Seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmengjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i
11 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit, znj. Sekretare.

14 Shoh që kemi një ndryshim të vogël të përbërjes së

15 ekipeve, kështu që do të doja t'ju jepja fjalën ju, z.

16 Prokuror, që të prezantoni kush është i pranishëm sot në
17 sallë.

18 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmengjes, të gjithëve. Sot

19 kemi të pranishëm në sallë Prokuroren e Specializuar, Kimberly

20 West, kemi gjithashtu edhe Line Pedersen, menaxhere e

21 çështjes. Kemi dhe dy stazhierë. Jam unë Prokurori, De Minicis

22 dhe gjithashtu edhe një prokuror tjetër nga Zyra e

23 Specializuar.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Z. Laws, ju lutem prezantohuni sot.

2 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të gjithëve. Jam Simon
3 Laws, kam së bashku dhe bashkëmbrojtësen për viktimat Maria
4 Radziejowska.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
6 Faleminderit.

7 Z. Gilissen, ju lutem prezantoni ekipin tuaj.

8 Z. GILISSEN: [Përkthim]. Mirëmëngjes, të gjithëve. Z.
9 Shala, na ndjek përmes videolidhjes. Së bashku në ekipin tim
10 është bashkëmbrojtësi z. Aouini, znj. Leto Cariolou, znj.
11 Dzeneta Petrovica, menaxhere e çështjes, znj. Kailin Chen,
12 oficere ligjore, Juliette Healy dhe Judit Kolbe. Dhe
13 gjithashtu edhe dy stazhierë të tjerë të cilët janë pjesë e
14 ekipit tonë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
16 rregull.

17 Z. Shala, na dëgjoni?

18 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Po, ju
19 dëgjoj fort mirë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e
21 përsërit edhe njëherë, z. Shala, çfarë thatë?

22 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes thashë. Ju
23 ndëgjoj shumë mirë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
25 rregull atëherë.

1 Do të vazhdojmë me deklaratat përbyllëse të Mbrojtjes së
2 Viktimave. Dje dëgjuaam prezantimin e Zyrës së Prokurorit të
3 Specializuar, ndërkohë që tani dua t'i jap fjalën Mbrojtësit
4 të Viktimave për sa i takon deklaratës përfundimtare për
5 pafajësinë ose fajësinë e të akuzuarit dhe propozimin për
6 dënimin e të akuzuarit në qoftë se ka.

7 Mbrojtës i Viktimave, juve na thatë dje që përveç kohës
8 që ju kemi caktuar që për këtë, që fillimisht ju keni kërkuar
9 një orë, mund t'ju duhet kohë shtesë. A mund të na thoni sesa
10 kohë ju duhet?

11 Z. LAWS: [Përkthim] Sipas llogarive të mia do më duhet
12 rreth 15 minuta më tepër, ndoshta pak më tepër sesa 15 minuta
13 po jo shumë më tepër sesa kaq.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull. E keni ju fjalën tani.

16 Z. LAWS: [Përkthim] Në deklaratën time hapëse për këtë
17 lëndë gjyqësore rreth 14 muaj më përpara, unë fillova duke
18 thënë këtë:

19 "Provat në këtë lëndë tregojnë se në periudhën e
20 përcaktuar në aktakuzë, fabrika e metalit në Kukës ishte një
21 vend që përkohësisht ekzistonte përtej sundimit të ligjit."

22 Dhe ajo çfarë doja të thoja unë me këtë ishte që fabrika
23 e metaleve në Kukës ishte një vend krimi dhe mizorie, një vend
24 ku nuk kishte asnjë mundësi për një të ndaluar apo të burgosur
25 që të bënte një ankesë dhe ku nuk dukej se kishte asnjë lloj

1 mundësie që të bëhej një ndërhyrje nga një organ gjyqësor apo
2 nga ndonjë organ tjetër ligjor. Përgjegjëse aty ishte UÇK-ja.
3 Dhe anëtarët e UÇK-së ishin personat që kanë kryer këto krime.

4 Provat e paraqitura në gjykim, ne parashtrojmë, e kanë
5 justifikuar përshkrimin, këtë përshkrim që unë sapo bëra të
6 fabrikës së metaleve në Kukës, pra, që funksiononte
7 përkohësisht përtej sundimit të ligjit. Ky i akuzuari dhe
8 persona të tjetër nga njëra anë kanë punuar nga një vend i
9 cili ishte afër një shoqërie të zakonshme dhe funksionale, por
10 nga ana tjetër ishte tërësisht e shkëputur prej saj.

11 Fabrika gjendej shumë pranë rrugës nga qendra e qytezës
12 së Kukësit, megjithatë në të njëjtën kohë, qelitë ku mbaheshin
13 të burgosurit e UÇK-së mund të gjendeshin edhe në fushat më të
14 djerra ose në xhunglat më të thella të planetit. Ata ishin
15 përtej arritjes së sundimit të ligjit.

16 Ajo çfarë dimë ne për situata të kësaj natyre është që
17 këto situata shpesh çojnë në abuzim, çojnë në torturë dhe në
18 vrasje. Një prej të këqijave lidhur me krimet të cilët kryhen
19 në konflikte janë që vendet e ndëshkueshmërisë lulëzojnë. Edhe
20 kjo është ajo çfarë ka ndodhur ekzatësisht në Kukës.

21 Disa njerëz, përfshirë këtu dhe dëshmitarë të cilët janë
22 thirrur nga Mbrojtja, duan të hiqen sikur nuk ka ndodhur
23 asgjë, nuk ka ndodhur asnjë krim atje. Por, fatkeqësisht, kjo
24 është thjesht një gënjeshtër. Atje janë kryer krime kundër
25 njerëzve të cilët nuk kanë pasur asnjëherë mundësinë që të

1 dalin përpara një gjyqi si ky, nuk kanë pasur asnjëherë
2 mundësinë që të shikojnë provat kundër tyre dhe aq më pak t'i
3 kundërshtojnë ato, por, në fakt, janë mbajtur në vende ndalimi
4 në mënyrë arbitrare.

5 Kur kanë qenë atje të burgosurit kanë qenë në mëshirë të
6 kapësve të tyre.

7 Ne duhet të kemi parasysh situatën e ndjerë, duhet të
8 kemi parasysh situatën e përzierjes së djeshmesh ndërmjet
9 sentimentit dhe ndjesive antiserbe dhe autoritetit absolut të
10 të burgosurve që akuzoheshin si bashkëpunëtorë të serbëve.
11 Pozita, situata në atë rast ishte absolutisht shumë e
12 cenueshme për të ndaluarit.

13 [REDAKTUAR] u lirua vetëm si
14 [REDAKTUAR]. Për të
15 tjerët, ata u liruan si rezultat i kolapsit përfundimtar të
16 regjimit serb në fund të bombardimeve të NATO-s. Megjithatë,
17 njëri prej tyre nuk arriti asnjëherë që të largohet gjallë nga
18 fabrika e metaleve në Kukës. Por, ai gjeti vdekjen mizore dhe
19 të panevojshme atje.

20 Për të mbijetuarit dhe në disa raste edhe për të afërmit
21 e tyre, plagët nuk janë mbyllur asnjëherë. Nuk duhet të jetë
22 befasi se ajo çfarë ka ndodhur aty ka pasur efekte që
23 vazhdojnë edhe sot e kësaj dite.

24 Mjedisi në Kukës ishte mjedis ekstrem, i paimagjinueshëm
25 për pjesën më të madhe tonën. Ishte një vend ku një grup

1 njerëzish vendosën që të mbyllnin njerëzit në qeli, t'i
2 rrihnin ata, t'i përçmonin, t'i përbuznin ata, t'i digjnin
3 ata, t'i prisnin ata, t'i torturonin ata dhe në mënyra të
4 tjera të cilat janë parashtruar nga prova. Pra, me fjalë të
5 tjera, ata mund të bënin çfarëdolloj gjëje me persona të
6 tillë.

7 Ne e dimë që ata që kanë dhënë dëshmi nuk janë të vetmit
8 persona që kanë vuajtur. Kemi dëgjuar edhe për persona të
9 tjerë gjatë këtij gjykimi, përfshirë këtu edhe gratë,
10 veçanërisht një grua, kemi dëgjuar rastin e muzikantëve romë,
11 dhe të tjerë të cilët janë keqtrajtuar në mënyrë të rëndë.
12 Mungesa e tyre në këtë gjykim mund të tregojë historinë e tyre
13 dhe përfshirja në një çështje kundër anëtarëve të UÇK-së nuk
14 është diçka që duhet të merret lehtë. Duhet që ti të kesh
15 vërtetë kurajo që ta bësh një gjë të tillë. Sepse në të
16 kundërtën rrezikon shumë. Në rastin më të mirë rrezikon
17 shpërfillje sociale dhe në rastin më të keq rrezikon sigurinë
18 personale.

19 Askujt nuk mund t'i hidhet faji që nuk ka vendosur që të
20 jetë pjesë e procesit gjyqësor. Megjithatë është e dukshme për
21 të gjithë ata, që kanë qenë në fabrikën e metaleve në Kukës që
22 nuk janë, nuk kanë qenë pjesë e këtij procesi që ata kanë
23 vendosur që të mbeten përtej sundimit të ligjit.

24 Megjithatë, pavarësisht kësaj, ka pasur shumë viktime që
25 kanë folur. Shumë prej tyre kanë pasur fuqinë dhe guximin për

1 të na treguar se çfarë i ka ndodhur atyre.

2 Sepse ekzistenca e fabrikës së metaleve në Kukës përtej
3 shtetit të së drejtës ka qenë vetëm e përkohshme. Njëra prej
4 gjërave që është demonstruar në këtë çështje është që viktimat
5 janë përgatitur dhe në qoftë se viktimat përgatiten që të
6 këmbëngulin, drejtësia mund të vihet në vend edhe pse pas
7 shumë viteve. Viktimat pjesëmarrëse në këtë çështje kanë
8 këmbëngulur dhe ata kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm
9 në këtë gjykim.

10 Në mënyra individuale, ata janë dëmtuar nga ajo çfarë ju
11 ka ndodhur në Kukës dhe dëshira e tyre, mbi të gjitha, është
12 që të shohin që drejtësia të vendoset në vend. Në këtë çështje
13 kjo do të thotë që i akuzuari duhet të dënohet, të cilin ata e
14 njohin shumë mirë, pasi ai është njëri prej personave që është
15 përgjegjës për dëmin e shkaktuar ndaj tyre, për këtë arsye unë
16 do të trajtoj çështjen e deklarimit fajtor të i akuzuarit
17 vetëm për pak çaste.

18 Disa prej të ndaluarve në Kukës kanë vdekur përpara sesa
19 kjo Gjykatë nuk kishte mundësi që t'i ofronte atyre një
20 mundësi për gjykimin e Pjetër Shalës. Megjithatë, zërat e tyre
21 janë dëgjuar në formën e dëshmive që ata kanë lënë pas tyre.
22 Fatmirësisht, të tjerët janë ende gjallë, ata kanë ardhur këtu
23 për të ndarë përvojat e tyre me ne.

24 Në rastin e Dëshmitarit 1, ne parashtrojmë se ajo çfarë
25 ju keni parë është dikush që zien nga përbrenda nga

1 padrejtësia e asaj çfarë ka ndodhur në Kukës. Dikush që jeta e
2 përditshme e të cilit mbizotërohet nga ngjarjet e së shkuarës.
3 Dikush, trupi i të cilit dhe memoria dhe kujtesa e asaj çfarë
4 i ka ndodhur atij, ajo çfarë ka parë ai që t'ju bëhet të
5 tjerëve, çfarë ka parë me sytë e veta, i shkakton djersitje të
6 ftohta, kur ai kujton atë çfarë ka ndodhur, një person i cili
7 acarohet shpejt, një person i cili nuk e gjen më veten siç ka
8 qenë, një person i cili dëshiron që do të kishte qenë mirë që
9 të ishte vrarë dhe ai atëherë. Ai vjen përpara këtij Trupi
10 Gjykues dhe ai akuzohet se gënjen. Sugjerohet që ai thjesht po
11 e sajton rolin e Pjetër Shalës në këto krime, do t'i kthehem
12 prapë kësaj çështjeje pak më pas.

13 Në rastin e Dëshmitarit 4733, i cili ka vdekur, ai i ka
14 shkaktuar, i ka dhënë shumë energji pjesës së mbetur të jetës
15 së tij për të kërkuar drejtësi. Dhe Pjetër Shala ishte njëri
16 prej personave që ai dëshironte që të shikonte që të sillej
17 përpara drejtësisë. Familja e tij me guxim e ka vijuar më tej
18 luftën ose betejën e tij në këtë Gjykatë. Dhe për arsye të
19 cilat janë të qarta, sipas Mbrojtjes edhe ai ka bërë
20 pretendime të rreme kundër të akuzuarit.

21 Në emër të tyre, pjesa e parë e asaj çfarë unë dua të
22 them trajton çështjen e kush po tregon të vërtetën këtu dhe
23 kush po gënjen. Pjesa e dytë e parashtrimeve sot paradite që
24 do të ketë të bëjë me dënimin do të trajtohet nga kolegja ime
25 znj. Radziejowska. Dhe, së fundi, më vonë gjatë javës, neve do

1 të trajtojmë çështjen e zhdëmtimeve.

2 Është një element i rëndësishëm. Po ashtu, më lejoni të
3 them, që analiza ligjore e Mbrojtjes sa i takon zhdëmtimeve
4 është e gabuar. Dhe mbështetet në leximin e pasaktë të ligjit
5 dhe, sikurse e thashë, në parashtrimet më vonë gjatë kësaj
6 jave ne do të trajtojmë çështjen e zhdëmtimeve.

7 Megjithatë, për ditën e sotme, dua që të flas së pari për
8 pikën e parë të rëndësishme: A ka qenë Pjetër Shala kryes në
9 fabrikën e metaleve në Kukës?

10 Në zemër të pozicionit të çështjes së Mbrojtjes është një
11 sulm i përgjithshëm sa i takon besueshmërisë së Dëshmitarit 1
12 dhe Dëshmitarit 4733. Ne, në emër të tyre, i kundërshtojmë
13 këto sulme të Mbrojtjes. Dhe sot paradite unë do të
14 përqendrohem në disa çështje që, sipas nesh, demonstrojnë se
15 ku qëndron e vërteta në këtë rast.

16 Dua të trajtoj shkurtimisht provat e thirrura nga
17 Mbrojtja dhe dua t'i trajtoj ato në dy aspekte ose në dy pika
18 të cila, sipas nesh, janë shumë të rëndësishme dhe që kanë të
19 bëjnë me Dëshmitarin 1 dhe me besueshmërinë e tij. Për ta bërë
20 këtë do ju kërkoja që të kalonim në seancë private, e nderuar
21 Gjykatëse. Sa i takon Dëshmitarit 1, pra, seanca private do
22 jetë thelbësore. Dhe më pas, unë kur të filloj që të trajtojë
23 çështjen e Dëshmitarit 4733, do kërkoj përsëri që të kalojmë
24 në seancë publike.

25 Edhe një herë do ju kërkoja, të nderuar Gjykatës, të më

1 jepni leje që të kaloj në seancë private.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, z. Mbrojtës i Viktimave.

4 Znj. Sekretare, na kaloni në seancë private.

5 [Seancë private]

6 [Seancë private teksti i fshirë]

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë e hapur]

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit.

5 Avokat i Viktimave, keni fjalën.

6 Z. LAWS: [Përkthim] Tani do të kalojmë në vlerësimin e
7 Dëshmitarit 4733, dëshmitar që nuk ka lidhje me Dëshmitarin 1,
8 të paktën të dukshme dhe ne do bëjmë të njëjtën pyetje: Edhe
9 ai paska gënjyer? Mesa duket, sipas Mbrojtjes, ka gënjyer edhe
10 ky. Nuk mund të jetë gabim, nuk mund të jetë gabim
11 identifikimi apo një gjë e tillë. 4733 nuk mund të ketë
12 përjetuar atë që e dimë që ka përjetuar dhe që doli prej aty
13 duke besuar, me besim me mendimin që një person tjetër ishte
14 personi që njihte me emrin Pjetër Shala, përveç të akuzuarit.
15 Kjo nuk mund të jetë e vërtetë.

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]

23 [REDAKTUAR].

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

- 1 [REDAKTUAR]
- 2 [REDAKTUAR]
- 3 [REDAKTUAR]
- 4 [REDAKTUAR]
- 5 [REDAKTUAR]
- 6 [REDAKTUAR]
- 7 [REDAKTUAR]
- 8 [REDAKTUAR]
- 9 [REDAKTUAR]
- 10 [REDAKTUAR]
- 11 [REDAKTUAR] .
- 12 [REDAKTUAR]
- 13 [REDAKTUAR] .
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR]
- 16 [REDAKTUAR]
- 17 [REDAKTUAR]
- 18 [REDAKTUAR]
- 19 [REDAKTUAR]
- 20 [REDAKTUAR]
- 21 [REDAKTUAR]
- 22 [REDAKTUAR]
- 23 [REDAKTUAR]
- 24 [REDAKTUAR]
- 25 [REDAKTUAR]

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 Pse do t'i thoshte këto Dëshmitari 4733 për këtë të
11 akuzuar? Ne themi sepse ai kishte të drejtë, ai i kishte
12 identifikuar këtë person që i ka bërë saktësisht ato që ai ka
13 përshkruar. Ky person të cilin ai e njohu gjatë rrugës nga
14 Ramanati në fabrikën e metalit dhe i njëjti person të cilin
15 personat në kerr e thërrisnin "Ujku", sepse ai e përshkruante
16 si një person që ulërinte si ujk në atë kerr dhe e pa që
17 rreshtonte të burgosurit që t'i rrihte dhe i rrihte duke
18 ulërirë.

19 Dhe më pas kjo u mbështet me një raport nga autoritet
20 hetimore në fillim të vitit 2002 dhe për këtë mund t'ju jap
21 referencën që ka numër SITF00013181 deri në SITF00013189 RED2
22 në faqen konkrete U0031378.

23 04733 nuk gaboi dhe është e qartë që nuk ka gënjyer.

24 Kur është intervistuar në 2019, i akuzuari ka thënë se e
25 ka parë 4733 në Kukës. Tha që e pa që po shërbente kafe. Pra,

1 ne e dimë që kanë qenë bashkë atje në të njëjtën kohë e
2 rrjedhimisht, ai ka pasur mundësi që ta sulmojë. Edhe më e
3 rëndësishme është të themi, që ai ka thënë se ai në të
4 shkuarën ka dash ta vrasë ose ta lëndojë seriozisht 04733 dhe
5 këtë ka dash ta bëjë pikërisht një vit përpara se të
6 kryqëzoheshin rrugët e tyre në Kukës.

7 Ju lutem të vendosim në ekran diapozitivin 12 dhe jo për
8 publikun.

9 "Nëse do e kisha kapur një vit më përpara nuk do të ishte
10 më në gjendje të jepte asnjë dëshmi. Fatkeqësisht, s'e gjeta
11 kurr.ë"

12 Pra, i akuzuari ka thënë që motivi i tij pse ka dash ta
13 lëndojë 4733 është për shkak të sjelljes së shkuar të
14 dëshmitarit apo për punësimin që ka pasur ky dëshmitar në të
15 shkuarën dhe për këtë s'ka asnjë provë, asnjë provë të vetme.
16 Këtë mund ta shihni në faqen 7421 të të njëjtës provë
17 materiale që ka të njëjtin numër reference si në ekran.

18 Sa u takon motiveve, ne themi që kjo është një shprehje e
19 qartë që ka pasur motiv. Ka pasur motiv ta sulmonte 4733.
20 Padyshim ka qenë atje në të njëjtën kohë si dhe 4733, ne këtë
21 e pamë, pra, ka pasur dhe mundësinë. Dhe duke marrë parasysh
22 edhe faktin që ka pranuar që ai ka gjuajtur me pëllëmbë, takon
23 që ai ka pasur mundësinë edhe prirjen për të ushtruar dhunë
24 ndaj të ndaluarve.

25 Dhe ky është personi për të cilin ju thoni që 4733 ka

1 bërë akuza të rreme. Që do të thotë kjo, që 4733 rastësisht
2 shpiku se i është ushtruar dhunë dhe këtë e ka bërë kundër një
3 personi jo vetëm që ka dashur të sillet në formë brutale
4 kundrejt tij, por që kishte edhe mundësinë ta bënte një gjë të
5 tillë.

6 Kjo habit çdo person sesi është bota reale, të lë pa
7 fjalë.

8 Në fund, sa i takon faktit a ka qenë i akuzuari kryes në
9 Kukës, ne duhet të shohim dëshminë e një dëshmitari të
10 ndaluarit tjetër që mban numrin 01448. ZPS-ja trajtoi dje dhe
11 unë nuk do të përsëris të njëjtat gjëra, po ai po ashtu ka
12 përshkruar një burrë me nofkën Ujku, me emër Pjetër Shala, që
13 po ashtu ka rrahur të ndaluarit në shoqërinë e Xhemshit
14 Krasniqit. Këtë mund ta gjenin në materialin SITF00013852-
15 0013869 RED5, në faqen SITF00013857.

16 Pra, kemi një person këtu që nuk ka lidhje me asnjë nga
17 viktimat pjesëmarrëse që ka përshkruar po ashtu rrahjen që ka
18 vuajtur ky person nën duart e Pjetër Shalës, unë do ju them
19 këtë. Është krejt e pazakontë që një i akuzuar të përmendet
20 nga disa dëshmitarë. Sepse këtë e ka bërë dhe një dëshmitar i
21 dytë, nuk mundet të jenë këto të gjitha rastësi. Kemi tre, më
22 së paku tre dëshmitarë që inkriminojnë z. Shala si një person
23 që ka ushtruar dhunë dhe ne po themi që nuk ka asnjë shpjegim
24 tjetër të arsyeshëm, me përjashtim të faktit që i akuzuari ka
25 qenë në të vërtetë një kryes në fabrikën e metalit në Kukës.

1 Edhe lidhur me këtë, dua të përmend sërish Dëshmitarin 1
2 dhe do citoj atë që ka thënë ai në këtë gjykim kur i bëri një
3 pyetje Avokati Mbrojtës. Mbrojtja i tha: Pse vendosët ta
4 përfshini emrin e Pjetër Shalës në atë që ka ndodhur në Kukës,
5 këtë e keni në transkriptin e 2 qershorit 2023, faqja 1692.

6 Pra, ju keni vendosur ta përfshini Shalën, i thotë
7 Mbrojtja.

8 Përgjigje:

9 "Po si mund ta përfshijë unë atë kur ai tashmë është i
10 përfshirë? Sepse ai na ka rrahur. Ai e di këtë. Këtu është. Ka
11 lidhje kjo me përfshirje apo implikim. Është çështje faktesh
12 për atë që ka ndodhur. Ai i bëri ato gjëra."

13 Ne themi që ndonjëherë ka momente gjatë një gjykimi ku e
14 vërteta është përpara të gjithëve dhe ky ishte një nga këto
15 momente dhe nuk kemi ç'i shtojmë më kësaj.

16 I akuzuari, ndryshe nga ata që u mbajtën të ndaluar në
17 Kukës, ka pasur një gjykim të drejtë. Edhe janë shqyrtuar me
18 imtësi të gjitha ngjarjet në fabrikën e metalit në Kukës dhe
19 me ndihmën e viktimave i është treguar përtej çdo dyshimi të
20 arsyeshëm se i akuzuari ka qenë pjesë e botës së paligjshme që
21 sundonte në fabrikën e metalit në Kukës. Por ama pjesëmarrja e
22 tij në krimet atje nuk është më përtej kthetrave të ligjit.

23 Kaq kisha unë për këtë temë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më
25 falni, që ju ndërpreva. Do të doja të kalonim për një çast në

1 seancë private. Dhe do ju njoftoj për çfarë.

2 Ju lutem të kalojmë për një çast në seancë private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23 [Seancë e hapur]

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Fjala

1 është për ju sërish.

2 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

3 Unë fjalën time e mbylla me kaq për pjesën e parë të
4 parashtrimeve tona, tani do t'ia kaloj fjalën
5 bashkëmbrojtëses, znj. Radziejowska.

6 Mendojmë se do kemi nevojë për 15 minuta, 20 minuta kohë.
7 Do të parapëlqenim ta bënim tani, të mos e ndërprisnim,
8 sidoqoftë jemi në duar e Trupit Gjykses nëse ju mendoni që
9 është më mirë një pushim.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse
11 keni nevojë për 20 minuta, nuk është mendoj që është problem.

12 Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

13 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Mikrofoni çaktivizuar]

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
15 Mikrofoloni nuk punon.

16 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Ju kërkojmë ndjesë, tani
17 është në rregull.

18 Të nderuar Gjykatës, parashtrimet tona për përcaktimin e
19 dënimit nuk kanë për synim të përsërisim gjërat që kemi thënë
20 në deklaratën për ndikimin që ka pasur viktimat kjo çështje
21 gjyqësore. Por ne duam të trajtojmë disa nga pikat që janë
22 trajtuar nga Mbrojtja në dosjen e tyre gjyqësore.

23 Fillimisht do të trajtoj disa nga parashtrimet e
24 Mbrojtjes sa i takon rrethanave individuale të të akuzuarit
25 dhe të rrethanave lehtësuese. Më pas, do të bëj disa

1 parashtrime të shkurtra sa i takon peshës së krimeve për të
2 cilat akuzohet z. Shala.

3 Ne kemi grupuar rrethanat individuale të të akuzuarit që
4 ka paraqitur Mbrojtja në kategoritë si më poshtë: Një, mosha e
5 të akuzuarit; dy, rrethanat sesi është rritur i akuzuari dhe
6 konteksti në Kosovë; tre, rrethanat familjare; dhe katër,
7 problemet shëndetësore.

8 Mbrojtja përmend moshën e të akuzuarit ë kohën e
9 ngjarjeve, thotë ka qenë 36 vjeç, sot është 61 vjeç. Kjo është
10 e përmendur në paragrafin 356 dhe 362 të dosjes së Mbrojtjes.

11 Sidoqoftë, Mbrojtja nuk shpjegon çfarë lidhje ka mosha e
12 të akuzuarit për përcaktimin e masës së dënimit të tij. 36
13 vjeç është një moshë e plotë e përgjegjësisë penale. Ku dikush
14 i di veprimet e veta, me përjashtim kur ka rrethana që duhet
15 të përjashtohet përgjegjësia penale, përndryshe një person
16 është përgjegjës penalisht për krimet që kryen në atë moshë.
17 Në rast të shpalljes së fajësisë, mosha nuk ka asnjë lidhje
18 për përcaktimin e masës së dënimit.

19 Po ashtu, Mbrojtja nuk shpjegon nëse edhe pse u dashka
20 marrë tani parasysh mosha e të akuzuarit, mosha 61 vjeçare për
21 përcaktimin e masës së dënimit.

22 Sikurse është thënë në aktgjykimin e apelit në çështjen
23 Mustafa, "jurisprudenca ndërkombëtare në mënyrë të vazhdueshme
24 ka refuzuar pretendimet se një dënim që kalon moshën
25 jetëgjatësinë e një personi është një lajthitje juridike në

1 përcaktimin e dënimit".

2 Mbrojtja thekson rrethanat personale të të akuzuarit që
3 lidhen me mënyrën sesi është rritur ai, jetën në Kosovë dhe
4 padrejtësitë që ka pësuar ai gjatë jetës së tij, për shembull,
5 që është rritur në një vend të pasigurt në Kosovë, është
6 mbajtur i ndaluar në një burg serb si i burgosur politik, ka
7 humbur të gjithë vëllezërit dhe motrat dhe një nip gjatë një
8 masakre gjatë luftës në Kosovë.

9 Por ne duhet të bëjmë këtë pyetje: Si qenkan këto
10 rrethana relevante për përcaktimin e masës së dënimit ndaj të
11 akuzuarit? A kanë ndonjë rëndësi për këtë qëllim? Rrethanat
12 sesi është rritur i akuzuari kanë ndikuar në kapacitetin
13 mendor të tij? Të jesh viktimë e një krimi a justifikon
14 kryerjen e krimeve të mëtutjeshme?

15 Të nderuar Gjykatës, në çështjen Ntaganda përpara TPN-së,
16 Mbrojtja argumentoi se "traumat e së shkuarës së një
17 kundërvajtësi janë shumë të rëndësishme për caktimin e dënimit
18 dhe mund të shërbejnë për të ulur masën e dënimit të një të
19 akuzuari". Dhoma e apelit në atë çështje doli me këtë
20 konstatim se "e shkuara traumatike sigurisht që është një fakt
21 që merret parasysh". Dhoma e Apelit theksoi se nuk u dha asnjë
22 provë për të treguar se i akuzuari në atë çështje kishte
23 pësuar dëmtime në tru apo forma të tjera të shëndetit mendor
24 për shkak të përvojave traumatike që mund të kishte pasur në
25 të shkuarën.

1 Të nderuar Gjykatës, në mënyrë që këto rrethana të jenë
2 relevante, sikurse pretendon Mbrojtja, Mbrojtja duhet të
3 vërtetojë se ka ndikuar të akuzuarin aq shumë sa që duhet të
4 shfajësohet për atë që ka ndodhur gjatë kohës së ngjarjeve.
5 Ama nuk u dha asnjë argument për këtë qëllim.

6 Mbrojtja përshkruan në dosjen e vet gjyqësore situatën
7 familjare të të akuzuarit. Është e paqartë si dhe pse
8 rrethanat familjare të z. Shala duhen marrë parasysh në
9 përcaktimin e dënimit. Nuk ka asnjë burim ligjor apo
10 jurisprudencë të paraqitur nga Mbrojtja për këtë. Sa i takon
11 jurisprudencës në fuqi, vetëm rrethanat familjare të
12 jashtëzakonshme merren parasysh si rrethana lehtësuese.

13 Në çështjen Bemba, në TPN, Dhoma doli me përfundimin se
14 "rrethanat familjare që pretendon Mbrojtja", si bashkëshortja
15 dhe fëmijët, "janë krejt të zakonshme për shumë persona që
16 shpallen fajtorë dhe nuk janë të jashtëzakonshme. Çka do të
17 thotë që nuk janë një rrethanë lehtësuese..."

18 Mbrojtja parashton se problemet shëndetësore janë
19 pranuar nga tribunalet ndërkombëtare si rrethanë lehtësuese.
20 Sidoqoftë, jurisprudenca përkatëse është më konkrete dhe
21 përmend vetëm raste të rralla apo të jashtëzakonshme. Dhe kjo
22 është konfirmuar nga Dhoma e Apelit të TPN-së në çështjen
23 Ongwen së fundmi. Dhe konfirmuan se shëndeti i një personi të
24 dënuar është një çështje që trajtohet pasi ky person e ka
25 marrë masën e dënimit edhe jo një faktor që merret parasysh

1 për përcaktimin e masës së dënimit.

2 Po ashtu, problemet shëndetësore mund të konsiderohen si
3 rrethana lehtësuese por vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe
4 ekstreme si probleme shëndetësore të jashtëzakonshme apo
5 sëmundje vdekjeprurëse.

6 Të nderuar Gjykatës, do të doja që tani të kalonim në
7 seancë private në mënyrë që të diskutonim problematikat,
8 problemet shëndetësore që paraqet Mbrojtja.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
10 rregull.

11 Ju lutem, të kalojmë në seancë private.

12 [Seancë private]

13 [Seancë private teksti i fshirë]

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Vazhdoni.

15 ZNJ. RADZIEJOWSKA: [Përkthim] Faleminderit.

16 Ne parashtrojmë se problemet shëndetësore të akuzuarit që

17 pretendon Mbrojtja nuk janë as ekstreme, as të

18 jashtëzakonshme. Për këtë arsye nuk mund të kenë asnjë rëndësi

19 në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënimit që do t'i jepet të

20 akuzuarit.

21 Më konkretisht sa i takon problemit shëndetësor,

22 rregullat kanë disa rrethana që janë problematika të shëndetit

23 mendor si rrethana lehtësuese, por nuk kemi asnjë provë që i

24 akuzuari të ketë ndonjë problematik të këtij karakteri apo të

25 kësaj natyre.

1 Tani dua të flas për disa rrethana lehtësuese që përmend
2 Mbrojtja.

3 Mbrojtja rendit një sërë rrethanash lehtësuese në dosjen
4 e vet gjyqësore. Argumenton pikë së pari se sjellja e mirë e
5 të akuzuarit, bashkëpunimi me autoritetet belge, me ZPS-në
6 dhe Dhomat e Specializuara duhet të jenë në favorin e tij.
7 Megjithatë, në çështjen e z. Shala, nuk mund të flasim për një
8 bashkëpunim të vullnetshëm. Mënyra si ka reaguar ndaj urdhrave
9 të Gjykatës, fletëthirrjeve, respektimit të ligjit - këto
10 rrethana nuk mund të përkthehen në bashkëpunim vullnetar.

11 Sjellja e mirë dhe respektimi i ligjit, urdhrave të
12 Gjykatës, janë një normë që priten prej të gjithëve.

13 Siç keni konstatuar ju, të nderuar Gjykatës, në çështjen
14 Mustafa, "respektimi i ligjit dhe urdhrave të Gjykatës priten
15 prej çdo personi dhe, në vetvete, nuk përbëjnë rrethanë
16 lehtësuese me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme".

17 Mbrojtja po ashtu rendit disa ankesa sa i takon gjykimit
18 të drejtë në dosjen e vet. Sa i takon masës së dënimit,
19 Mbrojtja pretendon se duhet marrë parasysh fakti që është
20 cenuar gjykimi, e drejta për gjykim të drejtë si faktor
21 lehtësues. Ne po themi që Mbrojtja e ka të paqartë reduktimin
22 e mundshëm të dënimit si mjet juridik për cenimin e gjykimit
23 të drejtë me rrethanat lehtësuese. Dhe ankesat që ngre
24 Mbrojtja, ne themi janë të pabaza.

25 Dua të trajtoj disa prej këtyre ankesave në kuadër të

1 dënimit.

2 Mbrojtja pretendon se ndërmarrja e përbashkët penale nuk
3 është shprehimisht në ligj dhe do ishte e padrejtë që Trupi
4 Gjykues ta zbatonte këtë.

5 Sa i takon cenimit të pretenduar të kushteve të
6 barabarta, Mbrojtja del në përfundimin se këto cenimet të
7 shumta e kanë paragjykuar procesin gjyqësor në përgjithësi dhe
8 këna ndikuar në parimin e një gjykimi të drejtë në mënyrë të
9 pakthyeshme. Kjo është në paragrafin 326 dosjes së tyre.

10 Të nderuar Gjykatës, këto cenime, nëse vërtetohet që kanë
11 ndodhur, po ne themi që nuk kanë ndodhur, nuk mund të zgjidhen
12 duke reduktuar masën e dënimit. Sepse nëse bëhet kjo nuk do
13 ketë një shpallje të fajësisë të vlefshme qysh në fillim. Këto
14 janë aspekte që lidhen me çështjen e shpalljen e fajësisë dhe
15 nuk lidhen me masën e dënimit.

16 Mbrojtja po ashtu pretendon se është cenuar e drejta për
17 gjykim publik. Kjo është për shkak se janë bërë shumë
18 redaktime dhe janë marrë shumë masa mbrojtëse. Sidoqoftë këto
19 masa janë zbatuar nga Prokuroria dhe Trupi Gjykues në
20 përputhje me ligjin dhe me rregulloren dhe janë bërë që të
21 mbrojnë dëshmitarët siç kërkohet dhe përligjet nga rrethanat e
22 kësaj çështjeje gjyqësore.

23 Sa i takon pretendimeve për cenimin e të drejtës së të
24 akuzuarit për ndihmë juridike efektive, vetëm, Trupi Gjykues
25 ka dalë në konstatimin që vetëm një intervistë, vetëm me një

1 rast që është bërë nga autoritetet belge, ka qenë një cenim i
2 kufizuar dhe ka qenë i pamjaftueshëm që të përjashtohet kjo
3 intervistë nga provat gjyqësore.

4 Të nderuar Gjykatës, kjo nuk mund të jetë një cenim që të
5 përlligjë reduktimin e një dënimi.

6 Sa i takon pretendimeve për nxjerrjen e materialeve, ne
7 themi që cenimet në fjalë nuk kanë asnjë ndikim në rezultatin
8 e këtij procesi gjyqësor.

9 Të nderuar Gjykatës, këto cenime, këto pretendime të
10 pretenduara nëse vërtetojnë - po ne themi që nuk ka sesi të
11 vërtetohen - nuk janë arsye për reduktimin apo uljen e masës
12 së dënimit dhe duhet të themi që jurisprudenca e TPNR-së që ka
13 përdorur Mbrojtja ka disa cenime shumë konkrete që i kanë bërë
14 garancive procedurale themelore në fazat e hershme të një
15 gjykimi që është e drejta për të informuar në kohë në rastin e
16 një arrestimi edhe paraqitja e vonuar e një personi pas
17 transferimit.

18 Asnjë nga pretendimet e Mbrojtjes nuk është pjesë e kësaj
19 kategorie.

20 Mbrojtja parashtron se ju, të nderuar Gjykatës, duhet të
21 merrni parasysh si rrethanë lehtësuese dhe kohën që ka kaluar
22 mes ngjarjeve në fjalë dhe procesit gjyqësor, por Mbrojtja nuk
23 jep asnjë referencë apo as një shpjegim për të mbështetur këtë
24 parashtrim. Mbi të gjitha, koha që ka kaluar mes ngjarjeve dhe
25 procesit gjyqësor është argumentuar tashmë nga Mbrojtja si një

1 nga elementet që ka çuar në cenimin e parimit të kushteve të
2 barabarta.

3 Dënimi për një krim që ka ndodhur para shumë vitesh, nëse
4 merret një vendim i tillë, nuk mund të ulet thjesht sepse ka
5 kaluar shumë kohë nga ajo ngjarje.

6 Kalimi i kohës nuk është konsideruar as si rrethanë
7 lehtësuese në çështjen Khmer Rouge i cili është një gjykim që
8 ka ndodhur 30 vjet pas krimeve në fjalë.

9 Ky propozim është në kundërshtim me të gjitha parimet që
10 janë në themel të gjykimeve për krime lufte. Nuk ka asnjë
11 status kufizues për ndjekjen penale të këtyre krimeve apo
12 periudhë parashkrimi për këto krime.

13 Gjithashtu, ne e kemi parasysh parashtrimet e Mbrojtjes
14 të cilët synojnë të zbusin peshën e krimeve që ka kryer i
15 akuzuari.

16 Në rast se ju, të nderuar Gjykatës, dilni me përfundimin
17 që i akuzuari është fajtor, gjëja e parë që duhet marrë
18 parasysh për përcaktimin e dënimit të tij është pesha e
19 krimeve për të cilat akuzohet.

20 Mbrojtja nuk shpjegon si dhe pse kuadri kohor dhe
21 gjeografik i kufizuar për krimet për të cilat akuzohet i
22 akuzuari e zbusin peshën e tyre.

23 Ndalimi arbitrar i viktimave në këtë çështje gjyqësore
24 është themeli për torturën mizore, torturën që kanë pësuar ata
25 dhe në një rast edhe vrasja e paligjshme. Ndalimi i torturës

1 është norma më e detyrueshme e të drejtës ndërkombëtare.
2 Vrasja është një nga format më të rënda të një krimi. Në këto
3 raste këto krime janë kryer të ndaluarve të pambrojtur, pa
4 zemër, pa shpirt, thjesht ndonjëherë edhe për të argëtuar
5 kryesit, përfshirë këtu të akuzuarin. Këto krime kanë ndryshuar
6 përgjithmonë jetën e këtyre viktimave.

7 Fakti që këto krime kanë ndodhur për një periudhë 20
8 ditore në një vend dhe kundër 18 viktimave nuk zbut peshën e
9 tyre. Tetë prej 18 viktimave kanë marrë pjesë në këtë proces
10 gjyqësor. Për ta, nuk ka asnjë lloj ndëshkimi që t'u kthejë
11 jetën që kanë pasur përpara Kukësit.

12 Të nderuar Gjykatës, ne nuk propozojmë ndonjë dënim,
13 ndëshkim konkret apo numrin e viteve burgim që duhet të ketë
14 ky i akuzuar në rast se shpallet fajtor sepse ne kemi të qartë
15 që viktimat pjesëmarrëse në këtë proces gjyqësor, nuk kanë
16 qenë të vetmet viktimat në këtë çështje. Dhe për të gjitha
17 arsyet që ne i kemi parashtruar në deklaratën, dedikimin e
18 viktimave, urojmë që ky dënim të jetë i konsiderueshëm.

19 Faleminderit. Dhe me kaq e mbyllim fjalën tonë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Faleminderit.

22 Okej. Përfunduar me deklaratën përmbyllësi të Mbrojtësit
23 të Viktimave. Ora është 11.05, është momenti që të bëjmë një
24 pushim të shkurtër. Rifillojmë në orën 12.00 pa një çerek,
25 propozoj unë. Shoh që pohoni me kokë ju nga ana e Mbrojtjes.

1 Në rregull atëherë. Mirë bëjmë pushimin.

2 Seanca ndërpritet këtu.

3 --- Pauza fillon në orën 11.06

4 --- Seanca rifillon në orën 11.48

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
6 se erdhët përsëri.

7 Tani të shohim nëse kemi ndonjë ndryshim nga ekipet e
8 Mbrojtjes. Z. Prokuror, kemi ndonjë ndryshim nga ekipi juaj?

9 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës. Jemi
10 të njëjtët si në mëngjes.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
12 rregull. Shikoj që Mbrojtja e Viktimave po ashtu nuk ka
13 ndryshim.

14 Po Mbrojtja e të akuzuarit, keni ndryshim?

15 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, z. Basile nuk është këtu.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
17 Ndërkohë që z. Shala, jeni i pranishëm, besoj që na dëgjoni,
18 apo jo? Na dëgjoni mirë?

19 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj,
20 faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
22 rregull atëherë. Do të vazhdojmë deklaratën mbyllëse të
23 Mbrojtjes së z. Shala.

24 Z. Avokati i Mbrojtjes, si fillim, ju keni kërkuar tre
25 orë e 15 minuta për sa i takon deklaratave përmbyllëse. Të

1 njëjtat komente zbatohen dhe në rastin tuaj ashtu siç edhe të
2 palëve të tjera. Domethënë dua t'ju pyes në qoftë se keni
3 ndonjë ndryshim të kohës së planifikuar.

4 Tani do t'ju jap fjalën.

5 Dhe sipas orarit të zakonshëm do të vazhdojmë deri në
6 orën 13.00 në parim. Megjithëse, duke marrë parasysh pjesët e
7 ndryshme të parashtrimeve tuaja mund të jetë e mundur që të
8 përfundojmë dhe pak më herët. Ose dhe pak më vonë në varësi se
9 si do të ecni me parashtrimet tuaja përmbyllëse, na e thoni
10 juve gjithsesi. Kjo është për ju për ta ditur, i nderuar
11 Avokat.

12 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar
13 Gjykatëse.

14 Faleminderit shumë, të nderuar Gjykatës. Znj. Prokurore e
15 Specializuar, kolegë të nderuar.

16 A e patë motin sot? E patë motin? Po bie shi, apo jo?
17 Edhe era është e tmerrshme. Është ditë jo e mirë për sa i
18 takon motit. Mund ta themi këtë gjë, besoj, apo jo? Pse ta
19 themi këtë gjë? Sepse unë dua që ne të kthehemi në realitet.
20 Unë dua që të kthehemi në realitet, dhe që të flasim për atë
21 çfarë ka ndodhur. Ne po flasim për hetime, po flasim për
22 mënyrën se si kjo procedurë gjyqësore është bërë e mundur. Dhe
23 si ka mundësi që një çështje gjyqësore të paraqitet përpara
24 jush, të nderuar anëtarë të Trupit Gjykues.

25 Ka pasur një rrugë goxha të vështirë derisa të vinte

1 çështja përpara jush, një rrugë e cila ka qenë e mbushur plot
2 me vështirësi dhe plot me pengesa. Dhe unë do thoja që pse
3 duhet të hiqemi sikur nuk ka asnjë lloj problemi, absolutisht
4 asnjë lloj problemi nuk është i pranishëm në këtë proces
5 gjyqësor. Sigurisht, ne të gjithë na duhet që të flasim për
6 këtë, pra të flasim në mënyrë të tillë që të dëgjohe mi. Të
7 flasësh në një proces gjyqësor ose në një proces juridik është
8 një përgjegjësi shumë e madhe. Dhe mendoj që të flasësh në një
9 rast të tillë kaq specifik sa çështja kundër Pjetër Shalës,
10 është një përgjegjësi edhe akoma më e madhe.

11 Mendoj se çështja që keni përpara jush, anëtarë të Trupit
12 Gjykes, është larg të qenit, dhe citoj, një çështje shumë e
13 thjeshtë, sikur është njoftuar në qoftë se ju kujtohet në
14 fillim fare të çeljes së procesit gjyqësor nga vetë Prokurori
15 i Specializuar. Dhe më duhet të them që në fakt tërësisht e
16 kundërta është e vërtetë. Kjo çështje mund të jetë një ndër
17 çështjet më të vështira që mbart me vete rrezikun real të
18 gabimit gjyqësor. Dhe nesër kur të dëgjoj -- kur dëgjova dje
19 në fakt dhe sot po ashtu se si kanë ndodhur gjërat, mund të
20 them që po, ne vërtet mund të kemi një problem me gabimin
21 gjyqësor, sepse gabimi gjyqësor asnjëherë nuk ndodh vetvetiu,
22 rastësisht. Gabimi gjyqësor gjithmonë ka histori nga mbrapa.

23 Të gjitha gjërat që ekzistojnë në planetin Tokë kanë
24 histori të mbartura pas vete, dhe gjërat që ne dimë janë si
25 rezultat i kësaj historie. Dhe ky është rasti në fakt edhe për

1 këtë proces gjyqësor.

2 Të gjithë profesionistët e së drejtës penale e dinë që
3 gabime të tilla vijnë si rezultat i zgjedhjeve fatkeqe të
4 hetuesve ose nga menaxhimi i keq i hetimeve, ose mund të
5 rezultojnë nga verbëria apo paaftësia për të marrë parasysh
6 pjesë të caktuara të informacioneve për ta vlerësuar atë në
7 mënyrë serioze apo për ta bërë punën ashtu siç duhet të ishte
8 bërë.

9 Në vendin tim, ne kemi një shprehje që themi që
10 Gjykatësit nuk janë përgjegjës për përmbajtjen e çështjeve që
11 çohen përpara tyre, por Gjykatësit janë përgjegjës për atë se
12 çfarë bëjnë ata me përmbajtjen që u paraqitet. Dhe më duhet të
13 them që pasi kam rishikuar dosjet, një pjesë e mirë e kësaj
14 çështje duket sikur ka probleme, vështirësi edhe veçanëri të
15 cilat janë të njohura mirë që janë vetëm një prej bazave të
16 gabimit gjyqësor. Por sa i takon kësaj teme, unë do të
17 mundohem të jem më specifik.

18 Ne do ju parashtrojmë argumenta dhe analiza si faktike
19 dhe juridike të cilat formojnë bazën e mbrojtjes së Pjetër
20 Shalës. Ne gjithashtu do t'i përgjigjemi disa prej argumenteve
21 të ZPS-së dhe argumenteve të paraqitura nga Mbrojtësi i
22 Viktimave që ose ju janë paraqitur në mënyrë të drejtpërdrejtë
23 ose janë parashtruar në dosjet përfundimtare të çështjes prej
24 këtyre dy palëve.

25 Dhe më duhet të them, e theksoj këtë: Ju lutem, vuajtja

1 dhe plagët nuk miratohen asnjëherë. Por ato nuk kanë asnjë
2 lloj lidhjeje me provën e pjesëmarrjes.

3 Dhe sigurisht -- sigurisht, më duhet të them se ajo çfarë
4 ka ndodhur në Kukës, në fabrikën e metalit në Kukës, ne e dimë
5 këtë gjë se në fakt dy vendime gjyqësore janë marrë lidhur me
6 të, kanë ndodhur ngjarje të tmerrshme. Nuk është fare në
7 diskutim kjo. Megjithatë kjo nuk ka të bëjë me diskutimin tonë
8 fare. Nuk ka të bëjë fare sepse baza e këtij gjykimi është që
9 të dihet në qoftë se z. Shala ka marrë pjesë në atë çfarë ka
10 ndodhur në Kukës apo jo, në qoftë se z. Shala ka marrë pjesë
11 në këto elementë.

12 Dhe ajo që çfarë dëgjova unë dje për shembull ishte që
13 kemi dëgjuar heshtje sa i takon deklaratës së mëparshme bërë
14 nga z. Shala, nga Pjetër Shala. Megjithatë, siç e dini,
15 realiteti është tërësisht i ndryshëm, është absolutisht i
16 gabuar, realiteti është që ne i kemi kundërshtuar këto
17 deklarata që në fillim fare. Nuk është puna se e kemi mbajtur
18 gojën të mbyllur, e kundërta është e vërtetë. Dhe ka arsye për
19 këtë gjë.

20 Dhe këtë e kundërshtojmë fuqimisht. Unë personalisht nuk
21 e kuptoj se si është e mundur që të flitet për lëshime të z.
22 Shala në deklaratat e mëparshme? Ju lutem, duhet të jeni
23 seriozë se ky është qëndrim i gabuar. Sigurisht që nuk ka
24 pasur asnjë lëshim, nuk ka pasur fare asnjë lloj pranimi prej
25 tij. Dhe dua t'ju them që ndërkohë që z. Shala ka shpjeguar --

1 atë, ajo që çka shpjeguar ka të bëjë me një skenë tjetër me
2 fakte të tjera në një moment tjetër dhe nuk ka lidhje fare me
3 atë u tha prej jush. Ju morët -- domethënë, ai ishte shpjegim
4 që ka thënë z. Shala.

5 Ju ose e merrni atë ose e lini atë, por në qoftë se juve
6 e konsideroni këtë si lëshim ju keni pas dy opsione. Ose ta
7 merrni ose ta lini atë. Dhe z. Shala asnjëherë, asnjëherë, nuk
8 është përqendruar tek ajo, nuk është fokusuar tek ajo. Dhe ai
9 nuk ka bërë absolutisht asnjë lloj lëshimi. E kundërta është e
10 vërtetë. Që prej fillimit, që prej ditës së parë më shumë se
11 sa 20 vite më përpara, sa herë z. Shala është pyetur për
12 diçka, ai ka shpjeguar haptazi. Ai nuk ka pasur pikë frike që
13 të shkonte dhe të takohej me hetuesit. Nuk ka pasur asnjë
14 frikë që të vinte në Hagë dhe që të paraqitej përpara
15 anëtarëve të Trupit Gjykses, edhe pa Avokat, sepse kur ti nuk
16 ke asgjë për të fshehur ti nuk ke frikë. Kur nuk ke gjë për të
17 fshehur, nuk ke pse fshihesh pas Avokatit Mbrojtës, ose të
18 mendosh që "Jo, kam arsye që nuk dua të shkoj, nuk dua të flas
19 me të." E komplet e kundërta është e vërtetë. Pra, z. Shala ka
20 qenë gjithmonë i gatshëm për t'iu përgjigjur.

21 Ai është larguar nga Kosova, por arsyeja nuk ka qenë që
22 ai ka dashur që t'i shmanget përgjegjësisë për të injoruar
23 çështjen. Nuk është ky rasti se pse ai ka ardhur në Belgjikë,
24 absolutisht jo. Por z. Shala sikurse e dini, ka jetuar në
25 Belgjikë përpara se sa të kthehej atje. Kështu që nuk ka arsye

1 se pse ju ta prezantoni që ai u largua nga Kosova për në
2 Belgjikë për t'iu shmangur përgjegjësisë. Më duhet të them që
3 jam pak i zhgënjyer me atë çfarë dëgjova, dhe një pjesë e mirë
4 e argumenteve janë keqpërfaqësuar.

5 Më duhet t'ju them që nuk është argument që të thuhet, që
6 të bëhet një karikaturë e këtij argumenti, nuk është,
7 karikatura e argumentit nuk është argument në vetvete. Ne tani
8 po flasim për argumentet reale, nuk po flasim për argumentet
9 false që jeni munduar që të paraqisni përpara gjyqit. Kur flas
10 për pranime, dhe më duhet të them që kjo shtrembëron
11 realitetin dhe po ashtu edhe fjalët dhe shpjegimet e dhëna nga
12 z. Shala janë shtrembëruar.

13 Megjithatë, nuk është e nevojshme që të bëhet e gjithë
14 kjo në proceset gjyqësore. Dhe për këtë arsye unë po dua që të
15 theksohen në këtë element, që të nënvizoj këtë element.
16 Dëshiroj të parashtroj argumente të ndryshme nga Mbrojtja, nga
17 ana e Mbrojtjes, megjithatë përpara se sa të futem në hollësi
18 me këto argumente, dëshiroj që të ndaj me juve disa mendime që
19 kanë të bëjnë me procedurën, sepse procedura në vetvete është
20 shumë e rëndësishme për Mbrojtjen në këtë çështje. Mendoj që
21 Trupi Gjykses, duhet që të marrë parasysh të gjithë këto
22 elementë parasysh, pra duhet që të gjitha këto reflektime t'i
23 marrë parasysh në kuvendimet e veta.

24 Në veçanti, jam i sigurt që këto konstatime duhet të
25 shërbejnë si informacion bazë për punën tuaj për ta analizuar

1 cilësinë e provave të administruara në këtë lëndë. Sigurisht
2 që ky është një proces shumë i thjeshtë. Kur ti merr një
3 pjesëz nga një tërësi informacionesh, përfshi këtu edhe
4 dosjet, a është e nevojshme që të them unë që panorama është e
5 plotë? Sigurisht që jo, nuk mund ta them këtë gjë, pra, sepse
6 për shembull, në qoftë se do të dëgjonim skenarin që u paraqit
7 nga ekipi i Prokurorisë dje, ose skenari që u dha nga Mbrojtja
8 e Viktimave sot, sigurisht në qoftë se nuk do kisha ditur
9 gjithë çështjen, do bindesha prej tyre. Por, në qoftë se di
10 përmbajtjen e çështjes, dhe në qoftë se ke të gjithë
11 informacionet përpara, sigurisht që do kishit një tjetër
12 përshtypje.

13 Por, në qoftë se ti përzgjedh ca gjëra nga e majta, ca
14 nga e djathta, ti ndërton një histori, një tregim, një rrëfim
15 vetë. Ose një skenar, siç e quaj unë. Kështu që do t'ju
16 lutesha që ndërkohë që keni shmangur shumë informacion, pse e
17 keni bërë këtë gjë? Pse e keni shmangur këtë informacion, pse
18 e keni shmangur problemin që ekziston? Sepse në fund të ditës
19 të gjitha këto probleme dua që të përballeshin dhe të
20 zgjidheshin nga të gjithë ne bashkë.

21 Përpara jush, anëtarë të Trupit Gjykses, faktet e sjella
22 datojnë në vitin 1999, dhe në qoftë se nuk e kam gabim me
23 matematikë, i takon që ngjarjet kanë ndodhur thujse 25 vite
24 më përpara. 25 vite është kohë e gjatë dhe sot paradite në
25 fakt dëgjuam të kundërtën, thamë që: 25 vite nuk janë kaq

1 shumë, nuk është problem, dhe nuk duhet që të merret parasysh
2 kjo veçori e çështjes. Megjithatë, sipas meje 25 vite janë
3 shumë kohë e kaluar dhe më duhet të them që brenda 25 viteve
4 çdo gjë thujse ka ndryshuar.

5 Mendoj që kanë ndryshuar gjërat, kanë ndryshuar kohët,
6 por mbi të gjitha kanë ndryshuar njerëzit. Shumë njerëz e
7 gjejnë veten në situata që janë tërësisht të ndryshme nga
8 situatat ku ata janë gjendur në të shkuarën, përpara luftës së
9 vitit 1999.

10 Pjesa dërrmuese e popullsisë së Kosovës sigurisht që e
11 konsideron situatën si shumë herë më të mirë tani se sa
12 situata ka qenë në vitin 1999. Megjithatë, për disa, gjërat
13 janë të ndryshme. Për disa ata kanë humbur të ardhurat e tyre,
14 kanë humbur statusin që kanë pasur. Dhe për disa ata kanë
15 humbur privilegjet në atë kohë. Për disa prej tyre, deklarata
16 e pavarësisë së Kosovës ishte një katastrofë e vërtetë sepse
17 ajo i vendosi ata në kampin e të humburve, e humbësve.

18 Si rezultat, nuk është befasuese që për disa hetimet
19 ishin një mundësi e papritur për të larë hesapet, ose madje
20 edhe për reprezalje, siç kemi dëgjuar që të shpjegohet prej
21 shumë dëshmitarë të Prokurorisë në deklaratat dhe në dëshmitë
22 e tyre të dhëna përpara jush, anëtarë të Trupit Gjykses.

23 Megjithatë, ne do t'i kthehemi këtij tipari të veçantë të
24 dëshmimeve të caktuara pas pak kohe, z. Aouini ka shumë gjëra
25 për t'ju shpjeguar lidhur me këtë pikë kur ta marrë fjalën.

1 Sepse pikë së pari, një gjë është e sigurt edhe është e
2 nevojshme që të nënvizohet: Efektet e kohës dhe rrjedha e
3 kohës janë reale dhe janë domethënëse në këtë çështje. Ne të
4 gjithë e dimë këtë gjë. Ne kemi parë me sytë tona pasojat e
5 kësaj. Dhe sikurse e dini, kalimi i kohës ka pasojat e veta.

6 Disa prej njerëzve që kanë qenë në fabrikën e metalit në
7 Kosovë [Sipas përkthimit] në vitin 1999, sot janë sëmurë, dhe
8 sëmundja e tyre nuk i bën ata të përshtatshëm që të jenë
9 dëshmitarë, dhe as që të japin edhe një deklaratë, duke pasur
10 ndikim kështu mbi cilësinë e dëshmive që mund të ofrohen prej
11 palëve.

12 Dua t'ju jap një shembull të vetëm. Ne jemi përpjekur
13 shumë e shumë herë që të kontaktojmë me z. Ruzhdi Saramati,
14 pse me Ruzhdi Saramatin? Me Ruzhdi Saramatin sepse ky person
15 pa diskutim ka qenë një person i rëndësishme në Kukës dhe në
16 veçanti ka qenë një person i rëndësishëm në fabrikën e metalit
17 në Kukës në vitin 1999. Është e sigurt që ai ka pasur
18 informacion të drejtpërdrejtë të lidhur me jetën dhe me
19 organizimin e fabrikën e metalit të Kukësit në kohën e
20 aktakuzës.

21 Dhe, për muaj të tërë, dhe për vite do të thoja, nuk ka
22 pasur pikë vlere që të përpiqemi që të takohemi me të. Ai nuk
23 është më plotësisht me ne. Është i paaftë për të kujtuar,
24 asgjë, apo nuk ka mundësi që t'i përgjigjet asnjë pyetje apo
25 për të pranuar apo për të refuzuar çdo propozim për t'u takuar

1 me të. Dhe pavarësisht kësaj, ky është realiteti. Ky është
2 realiteti i padiskutueshëm, rëndësia e takimit edhe thërritjes
3 së një personi të tillë për të dhënë dëshmi është e dukshme.
4 Çfarë humbje për sa i takon kërkimit të të vërtetës.

5 E njëjta gjë është e vërtetë edhe për të gjithë ata
6 persona të cilët kanë vdekur që prej asaj kohe. Dhe disa prej
7 tyre kanë vdekur edhe pa bërë asnjë deklaratë tjetër të
8 mëhershme. Ky është rasti i disa personave që na kanë referuar
9 z. Pjetër Shala, dhe i ka përmendur z. Pjetër Shala. Dhe kësaj
10 here kemi prapë pjesë tjetër të informacioni të humbur. Kjo
11 është dashur që të bëhej në mënyrë të tillë që këta persona të
12 kishin ardhur dhe t'ju kishin dhënë juve informacion për atë
13 çfarë ka ndodhur, të nderuar Gjykatës. Megjithatë, këta
14 persona siç e thashë kanë vdekur dhe nuk kanë pasur mundësi që
15 t'ju jepnin informacion ju, anëtarë të Trupit Gjykses. Edhe
16 këtu kemi të bëjmë me një pjesë tjetër të humbur të
17 informacionit.

18 Dhe pavarësisht se çfarë do të kishin thënë këta persona,
19 siç mund të imagjinohet, ne mund të ishim takuar me disa prej
20 tyre dhe mund të kishim marrë ca informacion të dobishëm për
21 të kërkuar të vërtetën. Megjithatë, edhe një herë këtu kemi
22 informacion dhe të vërtetë që është zhdukur përpara nesh.
23 Është informacion dhe e vërtetë që ju nuk e keni, as ne nuk e
24 kemi. Ju keni vetëm thjesht një pjesëz të vogël të realitetit
25 të asaj çfarë ka ndodhur. Është një pjesë torte. Megjithatë,

1 në qoftë se ti ke vetëm një pjesë torte ose keku nuk mund të
2 thuash që ke të gjithë tortën, në qoftë se ke një pjesë të
3 realitetit nuk mund të thuash që ke të gjithë realitetin. Një
4 pjesë e realitetit nuk mund të jetë e barabartë me të gjithë
5 realitetin. Dhe në të gjitha situatat, në të dyja këto
6 situata, duhet marrë parasysh që z. Shala nuk e dinte fare se
7 cili ka qenë shkaktar i kësaj humbje kryesore informacioni dhe
8 zhdukjes së provave.

9 Dhe më duhet të them që kalimi i kohës ka pasur më shumë
10 se sa një efekt negativ mbi provat.

11 Kemi të bëjmë me një numër jashtëzakonisht të madh të
12 arkivave dhe dokumenteve interesante për këtë çështje të cilat
13 nuk janë më të disponueshme dhe sigurisht që këto arkiva dhe
14 dokumente do të kishin qenë shumë interesante për këtë
15 çështje.

16 Mbrojtja e Pjetër Shalës nuk e ka pasur të mundur që të
17 konsultohet me këto dokumente sepse ndryshe nga Zyra e
18 Prokurorit së Specializuar ne nuk kemi marrë informacion nga
19 autoritetet serbe. Autoritetet serbe të cilat i kanë këto
20 arkiva dhe dokumente, ne nuk kemi përfituar nga ky
21 informacion. Dhe duket sikur autoritetet serbe janë shumë
22 krenare, janë shumë të lumtura dhe këtë gjë e kanë thënë edhe
23 përpara parlamentit serb, pra ata janë shumë të lumtur sa i
24 takon përdorimit të informacionit të saj, të një pjese të
25 informacionit që ata kanë zgjedhur që t'ia japin Zyrës së

1 Prokurorit. Dokumente të cilat ne nuk i kundërshtojmë dot.

2 Mbrojtja nuk ka fare qasje te këto dokumente dhe arkiva.

3 Të nderuar Gjykatës, as ju nuk keni qasje në këto dokumente

4 dhe arkiva. Dhe një herë kemi të bëjmë me një pjesë të

5 realitetit që tani në këtë moment është e aksesueshme, por ju

6 nuk e keni. Pra, ne nuk na është dhënë qasje në këtë

7 informacion, nuk e dimë arsyen pse, por ajo çfarë dimë me

8 siguri është që diçka ka ndodhur dhe ne nuk kemi pikë

9 informacioni lidhur me të. Dhe ne nuk mund ta kuptojmë se si

10 ky informacion i është dhënë vetëm njërës prej palëve. Dhe ne

11 nuk kemi pasur mundësi fare ta vëmë atë në pikëpyetje ose të

12 ngremë pyetje ose të njihemi me të.

13 Pastaj kemi të gjithë personat, individët e tjerë që i

14 kemi kërkuar më kot. Është fakt që ca njerëz thjesht janë

15 zhdukur. Ata nuk kanë lënë asnjë gjurmë pas. Mbase ata kanë

16 shkuar jashtë shteti ose ndoshta kanë filluar një jetë të re,

17 askush nuk e di këtë gjë. Por edhe një herë, kjo kategori

18 njerëzish na ka çuar në mungesën e një informacioni dhe e një

19 kuptimi të ndërsjellë të asaj se si ka qenë realiteti në

20 fabrikën e metaleve në Kukës në gjysmën e parë të 1999.

21 Sikurse mund ta shikoni, edhe kjo është një pjesë e

22 rëndësishme e realitetit që neve do ta kemi gjithmonë

23 informacion të munguar, është një informacion që asnjëherë nuk

24 do kemi qasje në jetë të jetëve. Dhe kjo ka ardhur vetëm si

25 rezultat i efekteve të kalimit të kohës. Megjithatë, nuk është

1 kjo gjithçka.

2 Nga ana tjetër mungesa e provave duket sikur vjen si
3 rezultat i përzgjedhjeve hetimore. Më duhet të them që disa
4 hetues, kanë ndodhur përzgjedhje hetimore jo të mira.
5 Megjithatë, në fakt, rezulton që shumë njerëz, emrat e të
6 cilëve paraqiten në deklaratat ose në informacione, në dosjet e
7 Prokurorisë, asnjëherë as nuk janë dëgjuar, dhe as nuk janë
8 ftuar që të japin deklaratë. Hetuesit nuk kanë kontaktuar fare
9 me këta persona, pavarësisht përmendjes së tyre në deklaratat
10 dhe informacione të mëparshme.

11 Megjithatë, duket sikur emrat e këtyre personave ju janë
12 dhënë hetuesve nga persona të cilët kanë qenë prezentë, kanë
13 qenë të pranishëm në Kukës në vitin 1999, dhe më konkretisht
14 në fabrikën e metaleve në Kukës në këtë kohë. Këta persona të
15 fundit në deklaratat e tyre kanë dhënë emra të shumtë të
16 personave ekzaktësisht për t'i identifikuar ata në mënyrë të
17 tillë që t'ju bënin atyre të mundur që të shpreheshin, të
18 dëgjoheshin, të konfirmonin deklaratat e tyre apo jo, ose të
19 konfirmonin apo të plotësonin informacione që kishin dhënë ata
20 në deklaratat e tyre. Dhe pavarësisht kësaj, asgjë nuk ndodhi.

21 Ata nuk u thërritën asnjëherë. Nuk ka asnjë gjurmë të një
22 orvatjeje për të kontaktuar me gjithë këta persona,
23 pavarësisht emrave të përmendurave nga disa prej personave që
24 kanë dhënë deklaratat për hetuesit.

25 Do t'ju përmend dy shembuj. Së pari, rasti i Shani

1 Berishës i cili është përmendur nga dy dëshmitarë të
2 Prokurorisë, them edhe një herë, dëshmitarë të Prokurorisë,
3 përkatësisht dëshmitari 402 dhe 404, kanë përmendur këtë
4 person si person me ndikim në fabrikën e metaleve në Kukës sa
5 i takon ndalimit të dëshmitarit 4.

6 Shembulli i dytë është një person me nofkën Loqka, që
7 është përmendur nga dëshmitari 4733 lidhur me arrestimin dhe
8 ndalimin e tij në fabrikën e metaleve në Kukës.

9 Ju duhet të mbani parasysh se ky person është përmendur
10 konkretisht në aktakuzën dhe në dosjen paragjyquese dhe
11 përfundimtare të Prokurorisë. Pra, është e pamohueshme që këta
12 dy persona janë relevantë për këtë çështje dhe për të kërkuar
13 të vërtetën. Kështu që më duhet të them që nuk e kuptoj, nuk e
14 kuptoj se si askush nuk ka gjetur kohë që të shkojë të takohet
15 me këta persona, t'ju bëjë këtyre personave disa pyetje e të
16 gjejë disa përgjigje.

17 Pasojat e drejtpërdrejta të kësaj kanë çuar në mungesën e
18 mundësive për të marrë konfirmime të deklaratave të caktuara
19 ose për të marrë informacion shtesë. Megjithatë, më duhet të
20 them që kur shikoj deklaratat ose deklaratat e mëparshme të
21 personave të përmendin emrat e personave të caktuar për
22 hetuesit, konfirmimi, të cilat paraqiten si të favorshme për
23 Pjetër Shalën, shpjegime të cilat janë dhënë nga Prokuroria,
24 pra kontaktimi i këtyre persona do të kishte qenë i
25 mirëpritur.

1 Megjithatë, dje askush nuk ka folur për këta persona,
2 persona të cilët kanë dhënë informacion shumë interesant
3 lidhur me Pjetër Shalën. Realiteti thjesht nuk ekziston, ekipi
4 i Prokurorisë nuk e njeh fare realitetin. Vetëm një pjesë e
5 realitetit ekziston. Por ajo që krijon problem, që krijon
6 shqetësim, është që s'kemi asnjë fjalë, qoftë edhe një fjalë
7 për të dhënë sqarime, heshtje e plotë.

8 Ju lutem, po flasim për çështjen, jo për dosjet tuaja. Po
9 flasim për çështjen, për atë të vërtetën, duhet të jemi të
10 vetëdijsëm për këtë.

11 Sidoqoftë, shumë informacione kanë humbur dhe natyrisht
12 kjo kërkon, bën pyetjen e detyrueshme: Si është e mundur që
13 pas më shumë se 20 vitesh hetime, asnjë hetues nuk ka gjetur
14 kohë për të intervistuar këta personat kur ishte akoma e
15 mundur?

16 Dhe pas kësaj, do të doja të shtoja edhe pyetjen tjetër:
17 Si është e mundur që në një çështje të tillë, pas më shumë se
18 20 vitesh hetimesh, Prokurori është vetëm, mund të sigurojë
19 vetëm 17 dëshmitarë, pothuajse një e treta e të cilëve nuk
20 kanë asgjë, asnjë lidhje me çështjen gjyqësore në fjalë, për
21 periudhën kohore të aktakuzës. Si është e mundur kjo?

22 17 dëshmitarë ndërkohë që mijëra njerëz si Pjetër Shala
23 kanë kaluar përmes fabrikës së metalit në Kukës në 1999. Këta
24 të gjithë ishin dëshmitarë, kanë qenë aty në vend, në atë
25 kohë. Është që konsiderohet, vlerësohet në aktakuzë si

1 periudha e veprave penale. Asnjë shenjë e këtyre njerëzve,
2 asnjë fjalë për këta. Mijëra njerëz të cilët si Mister Shala,
3 në të njëjtën mënyrë si z. Shala, nuk ishin të vetëdijshëm,
4 për gjithçka, nuk kishin njohuri për gjithçka që ndodhte në
5 këtë vend.

6 Nuk kemi asnjë shpjegim, asnjë fjalë, asnjë nga ana e
7 Prokurorisë për këta njerëz, apo nga, qoftë edhe nga Mbrojtësi
8 i Viktimave. Ju thashë, realiteti nuk ekziston. Këto janë pika
9 kyçe që dëgjova dje dhe sot në mëngjes.

10 Më tepër se kaq. Duhet dhe duhet të theksohet se studimi
11 i, analizave e dosjeve të zbuluara, të nxjerra nga Prokurori i
12 Specializuar për Mbrojtjen nxjerr në pah se asgjë nuk ka
13 ndodhur në hetime, për vite të tëra në hetimet kundër z.
14 Shala. Të nderuar Gjykatës duhet t'i kushtoni vëmendje faktit
15 se me sa duket për vite të tëra me radhë, deklaratat e shumta
16 të Dëshmitarit 01, ku Dëshmitari 01 pretendon, nuk janë,
17 Dëshmitari 01 për pretendimet që ka dhënë nuk janë marrë as
18 seriozisht. Është dashur që të bëhet një fushatë e shtypit në
19 Serbi për të ndërruar këtë, për të ndryshuar këtë situatë, për
20 të ndryshuar gjërat. Në fakt, këta të ashtuquajtura shumë
21 deklarata, të shumta, të dhëna nga ky dëshmitar as që janë
22 gjetur. Nuk, as që janë gjetur pavarësisht kërkimeve të shumta
23 që janë bërë për t'i gjetur. Çfarë rrëmuje.

24 Autoritetet përgjegjëse për të zhvilluar hetimet me sa
25 duket kanë humbur, kështu thotë dëshmitari të paktën. Të

1 gjitha këto deklarata që ka dhënë. Duhet të jemi seriozë.
2 Dëshmitari pretendon që ka dhënë deklarata të shumta. Në qoftë
3 se nuk bëj gabim, thotë kam dhënë më shumë se 100 deklarata.
4 Imagjinoj që kjo ishte në kuptimin figurativ, por imagjinoj që
5 nuk kanë qenë dy apo tre, të paktën ashtu siç thotë ai.

6 Duket sikur, është sikur se këto të ashtuquajtura
7 deklarata të shumta nuk kanë ekzistuar fare, dhe ky është një
8 problem i vërtetë për Mbrojtjen, dhe për të cilët natyrisht
9 për cilësinë e procedurës gjyqësore dhe vetë për juve, të
10 nderuar Gjykatës.

11 Ky është problem i vërtetë. Pse? Sepse Mbrojtja duhet të
12 ketë qasje në këto deklarata, qoftë edhe për të verifikuar që
13 ato nuk janë në kundërthënie me ato deklarata që janë dhënë më
14 vonë. Por në veçanti kur bëhet fjalë për një dëshmitar që ka
15 ndryshuar kaq shumë, në këto kushte nuk mund të argumentohet
16 që këto të ashtuquajtura deklarata të para mund të vlerësohen
17 si konfirmim i deklaratave të dhëna më vonë nga dëshmitari.
18 Dhe në fakt z. Aouini do t'ju sqarojë më në hollësi se ai ka
19 ndryshuar kaq shumë deklaratat e tija, sa që është bërë dhe një
20 kërkim formal për të, në përpjekje për të gjetur këto
21 deklarata të kundërshtuara.

22 Dhe në fakt kemi marrë një dokument, kemi pranuar një
23 dokument, referenca e të cilit është SPOE00168130-00168138
24 RED, për të justifikuar pse këto deklarata nuk janë gjetur në
25 asnjë moment. Ky është dokument i çuditshëm, pa nënshkrim në

1 të, dhe asgjë tjetër që mund të identifikojë autorin e këtij
2 dokumenti. Kjo do të thotë që deklarata të tilla kaq të
3 rëndësishme nuk janë përfshirë në databazën, pra, të
4 autoritetit hetues. Çfarë rrëmuje, duke ditur që bëhet fjalë
5 për një hetim ndërkombëtar.

6 Edhe këtu kemi qartësisht edhe një herë një humbje
7 jonormale të informacionit të cilat, në çdo rast sidoqoftë
8 dëmton Mbrojtjen. Dëmton njohurinë e lëndës, dhe kemi një
9 përpjekje jonormale për të justifikuar pohimin e pabesueshëm
10 të ekzistencës së deklaratave të shumta që kanë humbur nga
11 autoriteti përgjegjës për hetimet.

12 Pra, përfundimisht, ose këto deklarata ekzistojnë dhe
13 Mbrojtja duhej të kishte patur qasje në to, ose nuk kanë
14 ekzistuar kurrë dhe gjërat bëhen problematike sa i takon
15 besueshmërisë së këtij dëshmitari.

16 Kush e ka fajin, kush duhet të fajësohet për këtë
17 situatë? Serioziteti i hetimeve apo besueshmëria e vetë
18 dëshmitarit? Në të gjitha rastet, sidoqoftë, kjo bëhet në dëm
19 të interesit të të drejtave të z. Pjetër Shala, por edhe në
20 dëm të cilësisë dhe vetëdrejtësisë së procesit gjyqësor.

21 Një gjë duhet të theksohet lidhur me këtë. Sipas
22 Dëshmitarit 01, dosjet e kësaj lënde janë të paplota. Dhe
23 Mbrojtja nuk ka qasje në të gjitha dokumentet e mbledhura
24 gjatë hetimeve lidhur me çështjen e z. Pjetër Shala. Nuk
25 ngurroj të argumentoj dhe të parashtroj që një situatë e tillë

1 është shumë e rëndë për sa i takon pasojave të saj në një
2 çështje në të cilën ky dëshmitar nuk hezitoi që të pohojë se
3 Prokurori, i cili ishte përgjegjës në të kaluarën për hetimet
4 në këtë lëndë, i kishte manipuluar deklaratat e tij dhe
5 hetimet.

6 Duhet t'ju kujtohet kjo, se ky dëshmitar dhe jam i sigurt
7 që ju kujtohet, ky dëshmitar nën betim nuk do ta them emrin,
8 nën betim deklaroi se kishte manipuluar deklaratën dhe
9 hetimin. E pabesueshme, por ky është realiteti. Asnjë fjalë
10 këtu, natyrisht, dhe kjo është procedura me të cilën duhet të
11 merremi ne.

12 Mendimi i fundit lidhur me këtë. Nëse Dëshmitari 01 nuk
13 është marrë seriozisht për vite me radhë, mund të ketë ndodhur
14 sepse deklarata e deklaratave të tij që thuhet të ketë bërë
15 ndërsa fakti se besueshmëria, problemet e besueshmërisë që ai
16 ka takuar në procedurë. E dimë këtë nga dosja. Ky dëshmitar ka
17 dhënë deklarata të tjera në pjesë të tjera procesesh. Dhe e
18 dimë se çfarë ka ndodh në ato procese. Ka dhënë deklarata të
19 tjera në pjesë të tjera procesesh. Dhe e dimë se çfarë ka
20 ndodh në ato procese. Shtëpia e verdhë e kështu me radhë.
21 Asgjë. Asgjë.

22 Dhe ky dëshmitar si të tjerë duhet të shtoj, siç është
23 Dëshmitari 0144 -- 4733 dhe 1448, nuk janë vlerësuar si të
24 besueshëm dhe në të cilët mund të mbështeteshin për të dhënë
25 dëshmi përpara TPNJ-së si dëshmitarë, për Prokurorinë. Dhe nuk

1 janë vlerësuar të besueshëm në përpjekjen e tyre për të
2 akuzuar të akuzuarin, dhe dua të di me çfarë triku magjik këta
3 tre dëshmitarë vlerësohen të pabesueshëm në fillim të viteve
4 2000 dhe befasisht bëhen të besueshëm në 2024? Nuk dëgjova
5 asnjë fjalë për këtë.

6 Dëgjova që kemi një provë të mrekullueshme të fuqishme që
7 ky Dëshmitar 01, në të cilin ky dëshmitar thotë diçka. Në
8 rregull atëherë. Thotë diçka, në rregull. Po ku është
9 konfirmimi i kësaj që thotë? Ky është proces gjyqësor, nuk
10 jemi në kafe, nuk jemi në rrugë. Nuk dua thjesht të besojmë
11 deklaratën e njërit apo të tjetrit.

12 Si mund ta analizojmë një situatë të tillë, një humbje të
13 tillë të informacionit dhe natyrën përfundimtare, definitive
14 dhe të pariparueshme të kësaj humbje? A e parandalon kjo, a e
15 dëmton kjo gjykimin? Nuk e ka ndaluar deri tani. E kemi parë.
16 Por a mundet të mbahet, të zhvillohet një gjykim në kushtet e
17 tilla që duhet të japë garanci të mjaftueshme të
18 përputhshmërisë me kriteret e drejtësisë procedurale? Kur kaq
19 shumë prova, dëshmi, dokumente, dëshmitarë të drejtpërdrejtë,
20 dhe persona të tjerë të përfshirë të cilët ishin të
21 disponueshëm në kohën e duhur, por që janë neglizhuar nga
22 hetimet, janë bërë pastaj të padisponueshëm dhe janë zhdukur,
23 për shkak të kalimit të kohës. Por edhe për shkak të
24 zgjedhjeve të pavend. Abstenime të vërteta dhe mosveprim i
25 fajshëm i kryer gjatë shumë viteve. A mund gjatë hetimeve, a

1 mund t'i injorojmë ne për këto probleme jashtëzakonisht të
2 mëdha, që këto probleme që paraqes, që janë, paraqiten? Që
3 pretendohet që nuk ekzistojnë dhe kanë një efekt shkatërrues
4 në dëm të procedurës?

5 Për më shumë se 20 vite [Sipas përkthimit], disa misione
6 për gjetjen, mbledhjen e fakteve, duke punësuar dhjetëra
7 hetues, kanë punuar dhe me buxhete të majme në dispozicion të
8 tyre, e gjitha kjo për të përfunduar me këtë: Disa dëshmitarë
9 të përzgjedhur dhe duke përjashtuar dhjetëra të tjerë, të
10 cilët janë lënë mënjanë apo shmangur në mënyrë të qëllimshme.

11 Po ju jap një shembull këtu. Dëshmitari 4392, 4392. Kjo
12 është pjesë është një kyçe në këtë çështje. Ky është dëshmitar
13 kyç sepse ky dëshmitar ka qenë i pranishëm, natyrisht sipas
14 ekipit të Prokurorisë, gjoja ka qenë i pranishëm në, gjatë
15 skenës së parë të rrahjes. Ka qenë aty. Ky dëshmitar thotë që
16 ka qenë aty. Dhe mund të shmangim ndoshta kur përmenda gjininë
17 e dëshmitarit, kërkoj ndjesë, kur thashë "ajo".

18 Pra, ky dëshmitar, ka qenë aty. 4392. Ky është i vetmi
19 dëshmitar neutral në të gjithë këtë çështje gjyqësore. Nuk
20 është pjesë në procedurë, nuk është pjesë në, nuk është
21 viktimë. Është e vetmja dëshmitare e drejtpërdrejtë okulare që
22 ka parë, dëgjuar, dhe Prokuroria megjithatë ka vendosur që të
23 mos e thërrasë këtë dëshmitare. Nga çfarë keni frikë? Çfarë
24 doni të fshihni?

25 Dëshmitarit, ky dëshmitar i mbrojtur që ka refuzuar të

1 takohet me ne, prandaj megjithëse jemi përpjekur shumë, nuk
2 kam më absolutisht asnjë, nuk kishte asnjë arsye të ishte
3 kështu. Dje znj. Wyler e përmendi këtë dëshmitar, përmendi
4 hollësitë e tjera që ishte ndaluar, kishte pësuar dhunë
5 brutale, është shumë interesant të dëgjohet, të dëgjonim këtë
6 dëshmitar, ishte i vetmi person që mund të na jepte në
7 dispozicionin tuaj, që të na jepte informacion të
8 drejtpërdrejtë. Pra janë përzgjedhur dëshmitarët për të
9 shmangur vështirësisë, dhe unë them për të shmangur
10 realitetin. Por kërkimi i së vërtetës është detyrë, detyrim
11 për Prokurorinë, është rregull ajo. Dhe ju e dini shumë mirë
12 se pse ne e kemi bërë të qartë qëndrimin tonë lidhur me këtë.

13 Ne në anën e Mbrojtjes nuk kemi frikë nga realiteti. Çdo
14 herë që kemi patur mundësinë të marrim një deklaratë, kemi
15 bërë përpjekje dhe jemi përpjekur që të sigurojmë një
16 dëshmitar. Ka qenë e vështirë, shumë e vështirë. Pse? Sepse
17 siç u tha dhe nga Prokuroria dhe në këtë kanë plotësisht të
18 drejtë, ekziston rreziku për dëshmitarët.

19 Në këtë procedurë në veçanti, i vetmi person që ka bërë
20 kërcënime është Dëshmitari 01, askush tjetër. Nuk ka patur
21 kërcënime nga z. Shala apo dikush tjetër, vetëm ky dëshmitar
22 përpara jush, nën betim gjatë një seance gjyqësore ka shprehur
23 kërcënime ndaj z. Shala, gruas së tij dhe fëmijëve të tij.

24 Atëherë, duhet t'ju kujtoj të gjithëve neve që kemi
25 humbur dy ditë përpara që të vinte në Hagë. Kemi humbur një

1 dëshmitar sepse kishte frikë. Nuk pranoi të vinte. Ky
2 dëshmitar kishte nënshkruar dokumentin me të cilin pranonte që
3 të vinte, të paraqitej në Gjykatë. Pranonte që të takohej me
4 ne, të bisedonte me ne, edhe në fund fare kishte frikë, pati
5 frikë dhe nuk erdhi. Kishte kaq frikë saqë u fsheh për disa
6 javë dhe ju kujtohet juve, shërbimet e Gjykatës u përpoqën që
7 ta gjejnë atë, vendndodhjen e tij. Por po fshihej, sepse
8 kishte frikë.

9 Duhet të them që në momentin kur ekipi i Mbrojtjes u
10 caktua, kjo ndodhi më shumë se 20 vite [Sipas përkthimit] pas
11 fakteve të pretenduara me të cilat ngarkohet i akuzuari. Një
12 kohë e gjatë, pra, që nga momenti që kur është bërë dëmi. Në
13 fakt, duhet të nënvizoj faktin, që Mbrojtja është treguar e
14 kujdesshme për të nënvizuar këtë situatë që në fazën paraprake
15 dhe po citoj këtu referencën 4 mars 2022, Konferenca mbi
16 Ecurinë e Çështjes, faqe 226.

17 A mund të vazhdojmë të kemi qëndrimin seriozisht që kjo
18 situatë nuk do të, nuk ka patur ndikim në drejtësinë e
19 procedurës?

20 Pra duhet të jemi të kujdesshëm përpara se t'i
21 përgjigjemi kësaj pyetjeje. Nuk dua të veprojmë si në filmat e
22 heshtur ku njerëzit hedhin tortë tek të tjerët. Ju e dini që
23 Avokatët Mbrojtës ankohen shpesh për shkelje të rënda të të
24 drejtave të Mbrojtjes. Jo, nuk jam, po them kështu, duhet të
25 jemi të kujdesshëm përpara se t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje.

1 Së pari, mendoj që problemet që janë paraqitur nuk kanë
2 të bëjnë me ndërlikueshmërinë e fakteve apo kompleksitetin e
3 fakteve. Të gjithë ne kemi parë apo kemi qenë të përfshirë në
4 shumë çështje të tjera gjyqësore ku faktet kanë qenë shumë më
5 të pakta dhe më pak të vështira, dhe ku hetimet janë zhvilluar
6 në mënyrë të duhur në pak vite. Në pak vite.

7 Dhe as kompleksiteti i çështjeve politike, materiale apo
8 të sigurisë mund të shpjegojë vonesën e trajtimit të tyre të
9 tilla. Dhe dështime dhe skandale që në të kaluarën kanë
10 karakterizuar hetimet dhe ndonjëherë edhe misionet e
11 drejtësisë në Kosovë nuk mund të injorohen dhe të mbahen në
12 heshtje për sa i takon pasojave të tyre. Kjo është situata e
13 tmerrshme të cilën ju duhet ta mbani parasysh.

14 Pra, ka probleme reale, të vërteta që duhet të zgjidhen
15 dhe këto duhet të analizohen sa i takon përkueshmërisë së tyre
16 me atë që ekspertët ligjorë dhe ligji e quan atë kohë e
17 arsyeshme.

18 Siç e dini kjo lloj gjendje procedurale kërkon një
19 përgjigje në formën e kompensimit, në qoftë se ka ndonjë ose
20 në qoftë se kjo, ky kompensim është i mundshëm. Ndonjëherë
21 përgjigjja mund të shkojë deri në atë pikë që të deklarojë se
22 nuk ka kompensim që mund të kompensojë, pra, dëmin e
23 shkaktuar, dhe çështja deklarohet e papranueshme.

24 Siç e thashë në fillim të fjalimit tim, besoj që ky dëm
25 që kam përshkruar është në mënyrë të përhershme i pakthyeshem

1 dhe nuk ka asnjë mënyrë për ta riparuar atë.

2 Ju do ta vlerësoni këtë. Natyrisht, sepse ju, në qoftë se
3 jeni ju Gjykatësit e z. Shala, ju jeni së pari dhe mbi të
4 gjitha Gjykatësit e kushteve në të cilat kjo procedurë
5 gjyqësore përfundoi përpara jush, si dhe cilësitë, por edhe të
6 metat dhe gabimet në procedurë.

7 Pra, po ju parashtroj pyetjen juve në mënyrë të
8 drejtpërdrejtë dhe pa e shmangur asgjë. Cilat janë shanset e
9 organizimit të një mbrojtjeje të vërtetë të dobishme dhe
10 efektive në një kontekst të tillë? Natyrisht që ne mund të
11 vinim para jush me rroba të mrekullueshme, me pajisje luksoze
12 të mrekullueshme dhe falënderoj sinqerisht institucionin për
13 kushtet që na kanë krijuar për të punuar. Por në terren, në
14 realitet, kur njerëzit kanë kaq frikë, në qoftë se janë
15 gjallë, që kaq frikë saqë nuk pranojnë as të takohen me juve.
16 Sepse e dinë që në qoftë se punon me Mbrojtjen do të privohesh
17 nga liria për disa orë. Hetuesit, policët, ju marrin
18 telefonin, në qoftë se keni telefon, të marrin dhe telefonin.
19 Të marrin shënimet.

20 Si është e mundur të punohet siç duhet 25 vite pas
21 fakteve në kushte të tilla? Kjo është pyetje reale dhe besoj
22 që ju keni ndjesinë tuaj lidhur me këtë. Por kur jeni, kur je
23 në pozitën e Mbrojtjes, pas 25 vitesh pas fakteve, kjo është
24 realiteti në të cilin duhet të punojë Mbrojtja. Dhe vlerësoj
25 që nuk jam i çmendur që ju bëj këtë pyetje sepse është pyetje

1 që ne duhet të bëjmë dhe duhet t'i japim përgjigje çdo ditë,
2 ose pothuajse çdo ditë në këtë çështje.

3 Dhe nuk, po them, nuk pretendoj që është e pamundur për
4 neve të punojmë. Punojmë, punojmë shumë, por që të punosh në
5 mënyrë të duhur, siç duhet në kushte të duhura, me efikasitet,
6 kjo besoj është pyetja e vërtetë që duhet të bëhet.

7 Është e sigurt që cilëtdo qofshin mjetet e përdorura nga
8 Avokati Mbrojtës në një ambient të tillë, në kushte të tilla,
9 cilësia e Mbrojtjes zvogëlohet dhe po them, për të mos thënë
10 më tepër. Drejtësia, drejtësia e vërtetë, mbështetet në
11 marrjen e kësaj parasysh. Në fakt, edhe në qoftë se ju
12 vlerësoni se kjo situatë nuk e parandalon zhvillimin e
13 gjykimit, duhet të merrni parasysh atë që shpjegova për të
14 kompensuar këtë situatë.

15 Në respekt parashtroj para jush që mjete kompensues i
16 parë duhet të konsistojë në miratimin e, në zbatimin e një
17 kujdesi, shkalle kujdesjeje të jashtëzakonshme në mënyrën se
18 si të lexoni, interpretoni, analizoni provat, që ju dorëzohen
19 përpara jush.

20 Në rrethanat e përshkruara më lart, Prokurori ka vendosur
21 që të mbështetet veçanërisht në një numër të vogël
22 dëshmitarësh dhe të mos marrë parasysh deklaratat dhe dëshmitë
23 e dhëna nga disa persona të cilët ishin dëshmitarë të
24 drejtpërdrejtë të këtyre ngjarjeve. Qëndrimi jonë është se
25 është rrjedhimisht e nevojshme që të jemi, që të insistojmë,

1 të këmbëngulim lidhur me praninë e këtyre kundërthënieve,
2 ndryshimet e versioneve dhe shpjegime të pamundura, të
3 pabesueshme dhe irrelevante.

4 Do të doja që Mbrojtja të jetë jashtëzakonisht konkrete
5 lidhur me këtë pikë, dhe do të doja rrjedhimisht që t'ju jap
6 fjalën, që ju t'i jepni fjalën z. Auoini që të vazhdojë më
7 tej.

8 Ju falënderoj që më dëgjuat.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
10 Faleminderit, z. Avokat Mbrojtës.

11 Z. Auoini e keni fjalën ju tani.

12 Ju lutem.

13 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, z. Gillisen.

14 Mirëmëngjesi, të nderuar Gjykatës. Për të filluar, t'ju
15 jap disa përditësime për, ose të flasim pak për kohën. Shoh që
16 kemi 15 minuta kohë. Propozoj që të vazhdoj me pjesën hyrëse,
17 15 minuta, pastaj në seancë private do të trajtoj disa
18 dëshmitarë. Secili prej tyre kërkon kohë të ndryshme.

19 Tani ose mund të më lejoni pak më shumë kohë që të
20 trajtoj të paktën një dëshmitar në seancë private pas fjalës
21 hyrëse, për të bërë lidhje mes parashtrimeve që do bëjmë në
22 hyrje dhe disa shembuj konkretë me të cilët duhet të merremi
23 në seancë private. Përndryshe, mund të bëjmë pushimin dhe
24 pastaj kthehemi dhe vazhdojmë me parashtrimet publike dhe
25 private.

1 Vendimi është i juaji.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me sa
3 kuptova mirë, është propozimi është i fundit i juaji, është të
4 bëjmë ndoshta pushimin tani dhe pastaj të marrim një orë e
5 gjysmë pushim me qëllim që pastaj ju të bëni hyrjen pastaj,
6 dhe të vazhdoni më tej në seancë private që ju përmendët.

7 Z. AOUINI: [Përkthim] Kështu është. Ky është njëri prej
8 opsioneve, mundësive, opsioni tjetër është që të fillojmë
9 tani, por që në shkëmbim të na jepen 25 minuta dhe jo vetëm 15
10 minuta që do të na jepte kohë të trajtonim një dëshmitar.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,
12 por dua të marr parasysh kohën që përkthyesit kanë kaluar duke
13 punuar.

14 Ajo që po ju pyes është që në qoftë se është e mundur,
15 sepse mund të vazhdojmë pastaj deri në 13.15. Do lidhem me
16 ekipin e përkthyesve.

17 [Trupi Gjykes dhe Sekretarja e Gjykatës
18 këshillohen]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
20 Avokat, po, do ju lejojmë deri në 13.15. Fjala është për ju.
21 Dhe në orën 13.15 do bëjmë pushimin e drekës.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
23 Dhe faleminderit edhe përkthyesve.

24 Dhe mirëdita të gjithëve, të gjithë pjesëmarrësve këtu në
25 sallën e gjyqit.

1 E nderuar Kryetare e Trupit Gjykses, të nderuar Gjykatës.
2 Sot dua të flas për dëshmitarët e kësaj çështje gjyqsore dhe
3 gjegjësisht propozoj të flasim lidhur me aspektet e
4 besueshmërisë, të cilat duhet t'i keni parasysh, të nderuar
5 Gjykatës, në mënyrë që të dilni me një vendim penal të drejtë
6 dhe korrekt lidhur me akuzat që janë ngritur ndaj z. Shala nga
7 ZPS-ja në këtë çështje gjyqsore.

8 Të nderuar Gjykatës, ne si Avokatë Mbrojtës të z. Shala
9 pasi kemi analizuar gjithë dosjen gjyqsore, por edhe gjatë
10 gjithë kësaj kohe deri më sot, jemi befasuar, kemi ngelur pa
11 fjalë nga ndjenja e pazakontë se zëri i viktimave duhet
12 dëgjuar dhe duhet dëgjuar me kujdes, që të jemi të kujdesshëm
13 kur të ndajmë ato informacione që mund të besojmë nga
14 informacionet që nuk mund të besojmë.

15 Në fakt, të nderuar Gjykatës, unë e kam pasur privilegjin
16 të përfaqësoj viktimën bashkë me z. Gillisen në ditët e para të
17 Tribunalit Penal Ndërkombëtar. Dhe po ju themi që kjo çështje
18 gjyqsore ama është një çështje e dhimbshme, e parehatshme ku
19 nuk do të donim të ishim pjesë, sepse disa nga viktimat nuk
20 thanë të vërtetën dhe se disa viktimat bënë gabime.

21 Të jemi të qartë të nderuar Gjykatës, ne e pranojmë, siç
22 tha z. Gillisen, ne e pranojmë se kemi dëgjuar dëshmi kur
23 njerëzit kanë shprehur dhimbje, vuajtje, fatkeqësi, dhe ne e
24 pranojmë që kanë ndodhur ngjarje fatkeqe, vërtet shumë fatkeqe
25 në Kukës në 1999. Por është e qartë, të nderuar Gjykatës, që

1 kemi një rrezik këtu që po devijojmë rrugën e drejtësisë, sa i
2 takon zbulimit të vërtetës sepse janë bërë gabime dhe janë
3 keqpërdorur qëllimisht dëshmi nën betim.

4 Rruga e drejtësisë të cilët ndiqni ju, të nderuar
5 Gjykatës, në z. Pjetër Shala, ka nevojë që të shikohet me
6 kujdes. Duhet t'ju kujtojmë ZPS-së, Mbrojtësit të Viktimave,
7 Gjykatës dhe publikut se kjo është çështja gjyqësore e Pjetër
8 Shalës dhe të askujt tjetër. Dhe duhet ta përsërisim të
9 nderuar Gjykatës, atë që kemi thënë qysh në fillim. Çështja e
10 Kukësit nuk është çështja e Pjetër Shalës.

11 Dhe po themi, të nderuar Gjykatës, se ajo që duhet të
12 respektojë sundimin e ligjit, është të përcillet mesazhi i
13 drejtë i drejtësisë në mënyrë që Kosovës dhe banorëve të
14 Kosovës t'u garantojë që ekziston një shtet i së drejtës, dhe
15 që askush nuk duhet të ketë frikë nga shpërdorimet apo
16 lajthitjet juridike kur s'kanë bërë diçka të gabuar.

17 Ne po themi, të nderuar Gjykatës, që është detyra juaj
18 përkundrejt personave të Kosovës dhe të këtij burri që është
19 përballë jush, që të shqyrtoni të gjitha akuzat kundër tij.
20 Është detyra juaj të vërtetoni se askush nuk e ka peng
21 drejtësinë. Dëshmitë nën betim janë detyra më serioze dhe më e
22 shenjtë, detyra që ka një shtetas përkundrejt vendit të tij,
23 shoqërisë, historisë dhe trashëgimisë së asaj shoqërie. Dhe
24 nuk mund të përdoret kurrë për qëllime oportuniste dhe
25 përfitime personale.

1 Çështja e Kukësit që ju është paraqitur ju, të nderuar
2 Gjykatës, nuk do të thotë që nuk duhen ndëshkuar ata që vërtet
3 kanë kryer krimet. Çështja e Kukësit që keni dëgjuar ju është
4 që ne të mos lejojmë që të dënohet një person i pafajshëm për
5 veprimet e të tjerëve. Është thelbësore që ju, të nderuar
6 Gjykatës, të jeni të kujdesshëm që kjo Gjykatë drejtësisë të
7 mos mbështetet në thashetheme, në spekulime, në imagjinata.
8 Nuk është ky vendi për të zgjidhur hakmarrjet personale që
9 kanë njerëzit me njëri-tjetrin. Gjykata e drejtësisë është
10 peng, është peng, në qoftë, është vetëm peng i të vërtetës, i
11 dëshmive dhe provave që janë të një natyre të besueshme dhe të
12 mbështetshme.

13 Të nderuar Gjykatës, ne kemi thënë në dosjen tonë pozitën
14 tonë sa i takon besueshmërisë së dëshmitarëve dhe nuk do t'i
15 përsëris më këto parashtrime. Por me lejen tuaj të nderuar
16 Gjykatës, do të doja të flisja për disa nga pikat kryesore që
17 lidhen me dëshmitarët kyçë në këtë çështje. Flasim për
18 dëshmitarët kyçë dhe dëshmitë e viktimave, dhe dua t'u
19 kundërpërgjigjem disa parashtrimeve që ka bërë ZPS-ja dhe
20 Mbrojtësi i Viktimave, përkatësisht, dje dhe sot.

21 Fillimisht, të nderuar Gjykatës, Mbrojtja e z. Shala dhe
22 vetë z. Shala, duan ta bëjnë të qartë që ne qëllimisht
23 plotësisht i kemi fokusuar parashtrimet tona qofshin këto me
24 shkrim dhe me gojë, jo që të kundërshtojmë vërtetësinë dhe
25 saktësinë e fakteve lidhur me ndalimet dhe keqtrajtimet që

1 mund t'u kenë ndodhur viktimave në Kukës në 1999, por i kemi
2 fokusuar tek Pjetër Shala, dhe për faktin që nuk ka pasur
3 ndonjë prani apo pjesëmarrje të njëmendtë prej tij gjatë
4 periudhës së përcaktuar në aktakuzë si dhe në veprat penale
5 për të cilat ai akuzohet.

6 Arsyeja është e thjeshtë. Z. Shala nuk ka qenë i
7 pranishëm dhe nuk ka dëshmuar dhe nuk ka marrë pjesë në asnjë
8 nga akuzat për të cilat akuzohet. Kështu, për hir të së
9 vërtetës, dhe për shkak të dëmit që kanë vuajtur të
10 pafajshmit, ka qenë gjithmonë qëndrimi i Mbrojtjes që kjo
11 çështje nuk është thelbi i betejës juridike dhe provuese të
12 Mbrojtjes në këtë çështje gjyqësore. Qëndrimi i Mbrojtjes
